



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-2081/25
Kaçanik, 31.01.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I (parë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31.01 2025. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan me arsye: Florina Lika-Vishi dhe Agim Mani.

Nga Ekzekutivit i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Sali Malsiu-DSHMS, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Bejtulla Dalloshi, Maviye Murseli, Makfire Malsiu.

Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, Agim Mani me ka njoftuar se nuk ka mundësi me marrë pjesë në mbledhje.

z. Rustem Zenuni: Kryesues, Florina Lika-Vishi na ka njoftuar se nuk mundet me marrë pjesë në mbledhje, për shkak se kishte provim.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e fillojmë mbledhjen e parë të rregullt të KK për vitin 2025, data 31 janar, iu uroj punë të mbarë në vitin 2025. Për këtë mbledhje është paraparë ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XII (dymbëdhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës e datës 24.12.2024;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I (parë) e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës për vitin 2025 e datës 15.01.2025;
3. Plani i punës i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025;
4. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi -KKSB, për vitin 2024;
5. Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës, në vitin 2024;
6. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.104/02-31207/24 për miratimin e nismës për bashkëpunim ndër komunal me Komunën Iznik në Bursa të Turqisë;
7. Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.

Fillimisht iu njoftoj për vendimin për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave inerte. Vendimi është kthyer nga MAPL jashtë afatit ligjor, me arsyetime të cilat drejtori është zotuar se ka me i përmbushur, si çështja e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe përfshirja në PZHK, kështu nuk e kemi sjellë në rishqyrtim, pasi ligjshmëria na ka ardhur pas afatit ligjor. Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës prej 7 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XII (dymbëdhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës e datës 24.12.2024;

Procesverbalit nga mbledhja e XII (dymbëdhjetë) të rregullt e Kuvendit të Komunës i datës 24.12.2024 u aprovua njëzëri pa vërejtje. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi së kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së XII (dymbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, të datës 24.12.2024 / Lënda: 01Nr. 060/-31319/24.

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I (parë) e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës për vitin 2025 e datës 15.01.2025;

znj. Kadrije Lika Troni: Në emër të LVV konfirmoj se nuk do të marrim pjesë në votim, pasi që nuk kemi qenë pjesë e mbledhjes.

Procesverbali i mbledhjes së I (parë) e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës për vitin 2025 e datës 15.01.2025, u Aprovua pa vërejtje me 17 votë për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj Agim Çaka. Nuk votuan 7 anëtarët e LVV që ishin prezentë në mbledhje. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi së kuvendi i Komunës.

Aprovoj

Procesverbalin nga mbledhja e I (parë) e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës për vitin 2025 e datës 15.01.2025/ Lënda:01Nr.060/01-1154/25.

Kryesuesi i Kuvendit: Konstatoj me kaluar në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Ardita Rrahmani: Fillimisht uroj punë të mbarë në vitin 2025, e kam potencuar edhe në mbledhjen e jashtëzakonshme, shëndet e suksese.

1. Kam një shqetësim të kamotshëm dhe të përditshëm për prindërit dhe për banorët që janë në pjesën e rrugës kah çerdhja e fëmijëve. Rruga është tejet e ngushtë dhe nevojës për një parkingu, diku në afërsi të çerdhës së qytetit. Në mëngjes dhe pasdite aty krijohet kaos në vete, jo të rralla janë edhe aksidentet.
2. E përsërisë kërkesën për sanimin dhe rregullimin imediat të rrugës “Emërllah Kuqi”, për shkak të gjendjes që është. E kam adresuar edhe me herët si shqetësim, përgjigja ka qenë e përgjithshme. Po kërkoj edhe një herë që të merren veprime të nevojshme për intervenim të rrugës “Emërllah Kuqi”.

z. Naim Beça: Kam një kërkesë për ju kryesues. Tani janë zgjedhjet parlamentare, ne jemi këtu në Kuvendin e Komunës, kërkoj të mos përfshihemi në diskutime, çështje e analizave e të ngjashme për zgjedhjet nacionale, se nuk jemi këtu klub i gazetarëve. Neve këtu na intereson vetëm komuna e Kaçaniku dhe krejt çka kemi të bëjmë me këtë komunë.

Kryesuesi i Kuvendit: E kam parasysh kërkesën e juaj Naim.

z. Burim Shehu: Në lagjen "Besnik Begunca", nga sistemi i rrjetit të ujit që është prishur, janë shkaktuar 6 gropa, ndërkaq nuk janë sanuar ende. A ka mundësi me ditur, A do të sanohen ato gropa me asfalt? Këtë po e potencoj, sepse po kanë shumë probleme edhe fëmijët edhe veturat që kalojnë atypari.

znj. Kadrije Lika-Troni: 1. Kërkesa e banorëve të f. Kovaçec e muajit maj 2024, në DUKMM dhe në DSHPE, ku pronarët e pronave private japin komunës pjesë nga parcelat e tyre në mënyrë që rruga të jetë publike, ndërkaq komuna dhe drejtoritë përkatëse, jo që nuk dalin në terren, nuk formojnë ndonjë komision për verifikim, as që nuk kanë ndonjë transparencë për banorët. Sa duhet prituri banorët e këtij fshati që komuna t'iu drejtohet me ndonjë përgjigje? Kërkoj që kësaj here të ktheni përgjigje me shkrim në atë kërkesë?

2. Të ura e konakut, është vështirësuar kalimi i veturave për shkak të një grope të madhe. Singerisht nuk e di kah po kaloni ju që nuk po e vëreni. Kërkoj nga drejtoria përkatëse intervenim të menjëhershëm të asaj grope.

znj. Arta Avdiu: Ditëve të fundit është vërejtur se në lumin Lepenc janë grumbulluar mbeturinat. Desha me ditur, A i keni pa edhe ju dhe a keni marrë ndonjë veprim për largimin e atyre mbeturinave?

z. Agim Çaka: I kam dy pyetje: 1. Pastrimin e sheshit të qytetit, pishat nga dekorimi për vitin e ri e kam vërejtur se ende nuk janë larguar. Desha me ditur a keni me marrë veprime të nevojshme me hequr apo do t'i lënë tutje. Edhe shtëpizat që janë aty, me i larguar, se u krye koha e festave dhe duhet me u pastrua sheshi dhe me qenë i lirë për qytetarët.

2. A keni në plan me hapur, Çarshinë e qytetit, apo duam me prituri që çarshia e re me u bërë e vjetër dhe me bërë inaugurimin e saj? A ka mundësi që brenda kompleksit të çarshisë së qytetit me pasur lokacion për subjekte të partive politike?

z. Bashkim Luma: E kam një kërkesë për rrugën "Osman Luma" në f. Gllaboçicë, e cila ka kalueshmëri shumë të lartë, sidomos nga nxënësit, aty ka probleme të ndryshme, si çështja e mbetjes se ujit në rrugë gjatë sezonit të dimrit dhe dëmtimi i rrugës në çdo 3-4 metra.

z. Betim Shala: Pasi kemi hyrë në vitin e ri 2025, po dua me ditur të ndërtimi i rrugëve lokale, A ka hyrë në prioritet, ndërtimi i rrugës "Sylejman Kuka" dhe kanalizimi si dhe pjesa e rrugës "Skënderbeu" ku gjatë punimit të hekurudhës ka mbetur një pjesë e pashtuar. A mund të bëhet parking ajo pjesë?

z. Selajdin Troni: Kam një kërkesë për DSHPE, rruga: "Hamëz Jashari", është një kanal i madh i hapur. Kërkoj të shqyrtoni mundësitë për me rregullua ai kanal.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

3. Plani i punës i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025;

Në çdo vit në KK vjen për shqyrtim si informatë Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës. Është një dokument voluminoz, besoj se e keni lexuar. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Të Pjesa e raportit të DSHMS, ku thuhet do të bëhet dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shëndetësore si dhe sipas mundësive i gjithë hapësirës ajrore në komunën e Kaçanikut. Sa kam informacion, deinfektimi ajror ka vite e vite që nuk është bërë. A është në plan vetëm me u përmbushur si objektivë, cili është qëllimi që nuk është bërë? Pa të keq po e themi, por jemi në pikën që po duhet me bërë interaktiv debatin se nuk ka arsye me prituri 1 muaj ditë për një përgjigje.

z. Sali Malsiu: Dezinfektimi, dezinfektimi i hapësirës ajrore është e shënuar sipas mundësive, se nuk mundemi me bërë.

znj. Ardita Rrahmani: Nuk keni gjetur hapësirë ose nuk e keni pa të arsyeshme me pasur në prioritet dezinfektimin dhe dezinfektimin e hapësirës ajrore të Kaçanikut, se kjo po me intereson mua me ditur përgjigjen.

znj. Kadrije Lika-Troni: Drejtori duhet me dal përpara me u përgjigjur, se nuk po dëgjohej përgjigja nga vendi ku janë të ulur.

Kryesuesi i Kuvendit: Jemi duke folur për planin e punës të cilin e ka planifikuar ekzekutivi me e realizuar këtë vit. Pyetja që po shtrihet, është dashur me ngritur kur është shqyrtuar raporti i punës. Çështjet e parapara si në planin e punës, ka me ardhur përsëri në fund të vitit në raport të punës.

znj. Ardita Rrahmani: Unë këtë pyetje e kam adresuar në vitin e parë kur kam ardhur anëtare e KK, ndërkaq përgjigjen nuk e kam marrë asnjëherë. Janë procesverbalet, ka qenë i njëjti planifikim sipas mundësisë. Me intereson me ditur, A do të jetë prioritet kjo dhe kur do të bëhet? Përderisa është në një dokument që është publik, përgjigjen duhet me marrë, se unë e kam bërë një pyetje. Të njëjtën përgjigje e kam marrë kur e kam bërë pyetjen për herë të parë.

Kryesuesi i Kuvendit: Në muajin shkurt e kemi raportin e punës, që raporton ekzekutivi për punët që i ka kryer dhe mundemi me diskutuar edhe për temën që e ngritet. Sigurisht kjo objektivë ka qenë në plan edhe në vitin e kaluar.

znj. Ardita Rrahmani: Pyetja ime është: Kur do të bëhet dezinfektimi i hapësirave ajrore në komunën e Kaçanikut?

Kryesuesi i Kuvendit: Tani je e saktë në pyetje.

z. Selajdin Troni: Në plan të punës është theksuar që dezinfektimi i hapësirave ajrore do të bëhet sipas mundësisë. Qysh po e bëni ju pyetjen ju, kur ka me u bërë, kur është e shënuar që do të bëhet sipas mundësisë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Plani i punës është shumë voluminoz. Plani i punës është i Ekzekutivit, ndërkaq kërkesat tona nuk po merren parasysh. Si çështja e shtesave për lehonat nga 100€, me u realizuar si komunat fqinje, nuk e pash këtë në planifikim, bursat për studentë, rritja e numrit të tyre dhe shumë, rritja e orarit të kapacitetit të laboratorit në QKMF, kërkesa për një psikolog në QKMF. Këto plane nuk janë asnjëherë të harmonizuara as me buxhetin, ku në vazhdimisht kemi bartje, transfere të mjeteve, kjo është ajo që me shqetëson. Ne do të votojmë kundër këtij planifikimi, për derisa nuk merren parasysh kërkesat tona me hyrë në planifikim.

Kryesuesi i Kuvendit: Plani i ekzekutivit nuk votohet, plani i ekzekutivit na vjen si informatë në KK për me i ditur ne objektivat e ekzekutivit.

z. Sali Malsiu: Sa i përket pyetjes së Arditës, unë ia dhashë përgjigjen se do të bëhet dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shëndetësore si dhe sipas mundësive i gjithë hapësirës. Sa i përket asaj që e keni bërë pyetjen që e keni bërë në të kaluarën, e kemi iniciuar procedurën, por projekti ka dështuar për shkak të ankesave në OSHP dhe ne nuk mundemi me bërë dezinfektim të objekteve në dimër dhe e kemi anuluar.

z. Besnik Salihu: A keni kalkuluar drejtor koston e dezinfektimit të hapësirave ajrore, sa përafërsisht kushton dezinfektimi i hapësirave ajrore në komunën e Kaçanikut?

znj. Ardita Rrahmani: Pasi me u përmend emri, po bëjë replikë: Drejtor, përgjigjen të cilën e potencuat se keni iniciuar procedura të prokurimit, pastaj janë kthyer procedurat, unë sot po e dëgjoj. Ne nuk mundemi me ditur diçka që ju nuk e thoni publikisht. Të falënderoj që e shprehe sot këtë çështje. Në QKMF dezinfektimi i hapësirave shëndetësore bëhet nga vet QKMF, i kanë mjetet dhe e bëjnë me mjetet e tyre vetanake, ndërkaq ky është obligim i DSHMS. Është mirë me i ditur përgjegjësitë në përshkrim të detyrave, ndërkaq është çështje tjetër me gjetur hapësirë që diku me shtuar diçka, e diku tjetër me hequr.

z. Naim Beça: A është kërkesë apo plan, se nëse është plan, me hipoteza nuk bëhet plani? Plani nuk bazohet në hipoteza. Hipotezat janë po ose jo, ndërkaq plani bëhet për me u realizuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk ka plan që mundet me u realizuar 100%.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Ne edhe në vitin e kaluar e kemi planifikuar të njëjtin plan për me realizuar, është planifikuar edhe në këtë vit. Meqenëse procedura nga marsi – deri në fund të nëntorit kanë qenë në mes dy kompanive me ankesa kundrejt njëra tjetër, kur ka ardhur në nëntor, e kam pa të paarsyeshme me nënshkruar, se dezinfektimi nuk bëhet në fund të nëntorit -dhjetor. Në pjesën e kësaj, përpos objektit që është paraparë me u dezinfektuar, është paraparë edhe hapësirën që mendojmë se na paraqitet në kohë të caktuar ndonjë rrezik prej insekteve apo lavrave, se krejt Kaçanikun me dezinfektuar, nuk mundemi me bërë ne. Ne kemi kufirin me shumë komuna, Ferizaj, Viti, Hani i Elezit, Shtërpçen, dhe nuk mundemi me bërë dezinfektim, dezinfektimi ose bëhet në nivel nacional ose nuk bëhet hiq. Ne e patëm bërë dy herë dezinfektimin e shkollës në Doganaj, që ishte e rrezikuar njëherë prej insekteve, njëherë prej krimbave. Në procedurë të rregullt, ne ankesat nuk po mundemi me i ndalur në OSHP. Shpresoj të bëjmë dezinfektimin e hapësirave ajrore, me shpresë se nuk do të kemi ankesa në OSHP.

znj. Ardita Rrahmani: Kryetar, ju vini nga sfera e shëndetësisë, unë jo, ju jeni shumë me informuar se unë. Ju e dini se në shkollën “Emin Duraku” ka brejtës. Në një diskutim me QKMF thonë se rrezikohen nga sëmundja e gungave. Nëse kjo shfaqet tek nxënësit që bëhet bartja përmes brejtësve, nuk ka komuna kapacitet me përballuar. Dezinfektimi i shkollës “Emin Duraku” është bërë në kohën e pandemisë, ndërkaq përgjigjen ma ka dhënë drejtori i DA, se nuk është bërë më. Pyetje e kam ngritur në muajin nëntor në KK, dhe drejtori me ka thënë se do të bëjmë. Po ndërlidhem me atë se është nevojë me u bërë dezinfektimi i shkollës “Emin Duraku”, por nuk është bërë, kostoja ishte diku 80€. Për 80€ me i lënë fëmijët, stafin e shkollës me u rrezikuar, kjo nuk është në rregull.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Neve në momentin që na vjen një kërkesë për dezinfektim nga inspektorët, ne marrim veprime për dezinfektim nga komuna. Nëse na vjen një kërkesë emergjente edhe për shkollën “Emin Duraku”, të jeni të bindur se marrim veprime për dezinfektim, por për këtë shkollë nuk e kanë pru në gjendje të alarmit, se ne gjejmë forma tjera, që bëjmë marrëveshje të shpejta me kompani për dezinfektim, siç e kemi bërë 2 herë brena dy

javësh për shkollën në Doganaj, ndërsa në formë të rregullt, nuk mundemi me bërë pa procedura.

z. Agim Çaka: Kur bëhet një planifikim për punë, normal paraqitën prioritetet, dhe aty nuk shkohet nëse ka mundësi, ose bëhet ose jo. Në planifikim duhet me u potencuar se ka me u realizuar, si një prioritet i ekzekutivit. Në kuadër të kësaj, është dashur me u potencuar se dezinfektimi është një prej prioriteteve me të arsyeshme, që secili ekzekutiv duhet me pasur parasysh këtë çështje, varësisht se qysh apo ku paraqitet nevoja, në nivel lokal apo qendror, por si planifikim duhet të jetë në plan, si domosdoshmëri.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pasi është drejtori këtu, se e kam ngritur një pyetje në 1-3 seanca. Drejtor, a e keni planifikuar një psikolog në këtë vit në QKMF?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Agim, atë që e potencove për dezinfektim të objekteve, e kemi planifikuar, por e kemi lënë mundësinë për dezinfektim të hapësirave tjera. Vitin e kaluar kemi planifikuar 600 mijë euro pa planifikim për kontratën kolektive edhe këtë vit na vijnë një 1,5 milion, se nuk dimë se çka na vjen dhe dalim jashtë planifikimit, se na dalin obligime të papritura. Në këtë vit, me pasur hapësirë, e bëjmë dezinfektimin krejt, por edhe në këtë vit nuk kemi mundësi me bërë, ndërsa ato që na vijnë emergjente, duhet me i bërë me i kontraktuar se ashtu janë rrethanat, përndryshe kontrata kolektive ka me na sfiduar edhe në këtë vit. Për këtë arsye e kemi lënë mundësinë dhe mirë drejtori që e ka lënë mundësinë, se me thënë që ka me u bërë duhet me bërë, shpresoj të ndryshojnë gjerat për se miri dhe e bëjmë. Ne të gjitha komunat po e dimë që po sfidohemi për shkak të kontratës kolektive, për atë po e lëmë mundësinë, përndryshe si objektiva jemi të obliguar me i bërë dhe i kishim bërë, po të mos ishin çështja e ankesave të kompanive në OSHP, dhe çështja se kemi pasur mundësi me realizuar në fund të nëntorit. Kjo ishte arsyeja e vetme.

z. Agim Çaka: Unë po e kuptoj kryetarin, besoj se edhe kryetari me kupton mua. Dezinfektimi është i paraparë me ligj, dhe duhet me u realizuar. Nuk është këtu çështja, a po duam me bërë apo jo, ndërkaq çështja e kontratave kolektive është diçka tjetër.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Përmbaruesi nuk po me pyet për mjetet me kontratën kolektive, veç po na i merr. Ai po të jep një afat prej 6 muajve, se ku me i marrë mjetet. Kontratën kolektive nuk e kam bërë unë, javën e kaluar na i ka marrë 114 mijë euro me përmbarues me vendim të dhomës së Apelit. Ne dimë kush e ka bërë kontratën kolektive, por ne po ndëshkohemi.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk duhet të flasim me tendenca këtu, ne e dimë kush e ka bërë kontratën kolektive, e dimë çka përmban kontrata kolektive dhe dimë qysh janë ngarkuar komunat me kontratën kolektive.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kush e ka bërë kontratën kolektive?

Kryesuesi i Kuvendit: E ka bërë qeveria e Kosovës, zbatuese me përmbushur kanë qenë ministria e Financave dhe ministria e Arsimit, ndërkaq barrën ia ka gjuajtur komunave me përmbushur. Kontrata kolektive ka me ta cenuar këtë plan Agim, jo vetëm dezinfektimin, por projektet kapitale, mallrat dhe shërbimet, se ka me qenë detyrim i pa planifikuar i komunave me përmbushur. Ne krejt e dimë këtë, se kur ti merr dikush mjetet, nuk mundesh me realizuar një projekt, me këtë problem po përballen krejt komunat e Kosovës.

z. Agim Çaka: Unë nuk po dua të dal të kontrata kolektive, por të dezinfektimi, se të kontratat kolektive nuk kemi çka me bërë, duhet me i lënë disa prioritetet e me i bërë pagesat e kontratës.

Ndërkaq, dezinfektimi i hapësirave ajrore, është një çështje që i takon nivelit qendror, që e potencoj edhe kryetari, ne duhet me u fokusuar të dezinfektimi i objekteve.

Kryesuesi i Kuvendit: Për çështjen e objekteve, gjenden format dhe realizohet në formë tjetër.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kërkoj përgjigje nga drejtori në pyetjen që e ngrita, a është në planin e punës së drejtorisë një psikolog në QKMF, sepse është shumë e nevojshme,?

z. Sali Malsiu: Përgjigjen e kam dhënë në formë të shkruar. Ne po ua dërgojmë përgjigjet me shkrim, ndërkaq ju po kërkon përgjigjen edhe me gojë. Kjo nuk është në rregull, unë nuk e kam problem me ua lexuar përgjigjen, mundem t'ua lexoj.

znj. Kadrije Lika-Troni: Drejtor, jemi të planifikimi dhe të lutem mos ofendo, se me janë dashur 3-4 muaj me prituri unë, që ju me u përgjigjur. Ju nuk e kuptoni pyetjen time, ju po thoni se unë nuk di me lexuar përgjigjen, ndërkaq ju nuk e kuptoni pyetjen. Kuptimi dhe leximi janë dy opsione të ndryshme. Ju duhet me ditur njëherë e mirë me u përgjigjur, se ju jeni i emëruar i kryetarit, ndërkaq unë jam i përzgjedhur prej qytetarëve dhe ju duhet me dhënë llogari, e jo me neglizhuar pyetjen për tre muaj radhazi. Unë po dua direkt përgjigjen, se është me së e nevojshme një psikolog në QKMF. Po dua me ditur, A ka hyrë në planifikim të drejtorisë (DSHMS) për këtë vit, kërkesa ime për një psikolog në QKMF?

z. Selajdin Troni: Për derisa është dhënë përgjigja me shkrim, pse po e shfrytëzon tani për të njëjtën pyetje, me të dhënë përgjigje edhe me gojë.

znj. Kadrije Lika-Troni: E tregova arsyen, sepse e ka neglizhuar dhënien e përgjigjes. A po thotë se brenda 1 muajin duhet me kthyer përgjigjen? Mua me janë dashur me prituri 3 muaj, derisa është dhënë përgjigja.

z. Selajdin Troni: Nuk shkon kjo, sa herë të doni ju, me iu dhënë përgjigje me shkrim dhe me gojë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,
NJOFTOHET

Me Planin e punës i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025/ Lënda: 01Nr. 104/02-1746/25.

4. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi -KKSBB, për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani; Kryetar, ju nuk keni që atë ditë në KPF kur e kemi diskutuar këtë plan pune, kështu që po të informoj. Plani i punës i KKSBB është obligim që rrjedh prej ministrisë, ndërkaq duhet me u realizuar nga ne. Mundemi me thënë, përbërja është apo nuk është e mirë, tjetër kush e ka vendosur. KKSBB në çdo dy muaj mban nga 1 mbledhje. Komuna jonë i ka mbi 27 mijë banorë, dhe në çdo të dytën mbledhje me u diskutua trajtimi i qenve endacak dhe me përfunduar aty, kjo për mua nuk është në rregull. Raporti na ka ardhur me 2 faqe, ku shënohen pikat që janë diskutuar. Është shqetësimi im dhe i LDK për Kaçanik, për komunat tjera nuk jam interesuar se çka trajtojnë. Ka shumë çështje që duhet të trajtohen, të cilat nuk trajtohen asnjëherë si çështja e arsimit. E kuptoj se ky komitet është për çështje të sigurisë, kjo temë diskutohet në çdo të dytën mbledhje, tema këto që i konsumon KKSBB me së shumti.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: KKSBB e formon fillimisht një komision për hartimin e Planit të punës së tij, pikë kjo e cila na ka ikur, se është dashur me u trajtuar në këtë mbledhje. Pikat që do të trajtohen, i cakton këshilli i KKSBB. Nga diskutimet e pikave që trajtohen, dalin rekomandimet, ndërkaq sesa kemi mundur me i realizuar, ajo është diçka tjetër. Raporti

mundeni me thënë se është i shkurtër, por janë paraqitur temat që janë diskutuar dhe rekomandimet, jo edhe diskutimet, se me pas përfshirë edhe diskutimet, ishte bërë raporti voluminoz. Të çështja e qeneve endacak, ne e kemi ngritur sa herë këtë shqetësim edhe me ju. Ne kemi menduar se ka me u bërë një Strategji nacionale, që ka me pasur efekt në nivel vendi, por kjo nuk është bërë. Se është problem me trajtuar vetëm Kaçanikun, nëse nuk trajtohen Hani i Elezit, Vitia, Shtërpca, Ferizaj, se janë bartur qentë nga një vend në një vend tjetër dhe e kemi problem me i kontrollua. Ne ndajmë mjete, por është e pamundur me i trajtuar, se qenin po duhet me e trajtuar a është i infektuar, se është i rrezikshëm për shoqërinë. Në Australi e kam parë gjatë pandemisë, kur u rritën kangurët, vet qeveria e lejoj me i vra 500 mijë, ndërkaq neve na thonë është shkelje e të drejtave të njeriut. Të ne, pasi të rrezikohen fëmijët, pas 3 ditësh e behët lajm. Vet shoqëria civile i ka fajet, se po ngritët me popullin dhe nuk po na lenë një strategji, se ne deri në vitin 2014 e kemi pasur një strategji, janë eliminuar qentë endacak në bazë të asaj strategjie. Nuk po kemi alternativë, se nuk kemi arritur një gjuhë të përbashkët, me bërë një strategji, qoftë me këtë qeveri apo me qeverinë paraprake në nivel vendi se çka me bërë. Propozimi i dytë që po rrjedh gati që 2 vite, ne kryetarët e komunave kemi kërkuar mos me pasur strehimore në çdo komunë, se nuk kemi mundësi me i mbajtur, por se paku me qenë strehimoret nëpër regjione, u bë me letra, u ndanë mjete, por nuk u realizua. Me rekomandoni një formë, bashkërisht ju përkrahim, se seriozisht po themi se nuk kemi arritur me gjetur ndonjë formë.

z. Naim Beça: Është problem me zgjidhur këtë çështje, Ferizaj e ka zgjidhur këtë çështje, se krejt qentë e Ferizajt, po na i sjellin në Kaçanik.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Pikërisht kjo është Naim, po i sjellin qentë endacak prej komunave tjera në komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendi: Nuk është zgjidhje me i bartur qentë endacak nga një komunë në komunën tjetër. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me Raportin e punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi -KKSB, për vitin 2024/Lënda: 01Nr. 104/02-1666/25.

5. Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës, në vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendi: Materialin e keni marrë, Informata është bërë në vija të trasha, e ka hartuar zyrtarja e KK, ku janë përfshirë të gjitha mbledhjet, çështjet që janë shqyrtuar, vendimet që janë marrë. Nëse ka kush diçka urdhëroni:

z. Rustem Zenuni: Sa i përket Raportit të punës së Kuvendit të Komunës, është një raport shumë i mirë i hartuar, ku është paraqitur secili grup sa ka qenë aktiv, se kemi pasur tema që janë grumbulluar në opinion publik, por kur ato çështje iu kanë adresuar KK, ata që i kanë ngritur, nuk kanë qëndruar në sallë. Është hera e dytë që vjen raporti në këtë format dhe është për tu lavdëruar. Sesa jemi aktiv, flasin veprimet e mia, unë e mbaj mend një deputet në Kuvendin e Kosovës që ka qenë shumë aktiv, ndërkaq kur ka dal në popull, ka mbetur jashtë kuvendit, kështu që nuk e marrë shumë seriozisht sa ka qenë aktiv një anëtar i KK, se veprimet e dëshmojnë sa ka qenë aktiv.

znj. Ardita Rrahmani: E falënderoj sinqerisht zyrtaren, Makfire Malsiu, për përgatitjen e këtij raporti. Të gjitha çështjet janë përfshirë në raport, ndërkaq çështja se me çka pajtohem apo nuk pajtohem, ajo është diçka tjetër. Në emër të LDK e falënderoj zyrtaren e KK për këtë raport pune, dhe për kontributin e dhënë gjithmonë në punën e KK.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Komenti me i miri është ky.

Kryesuesi i Kuvendi: Zyrtarja Makfire Malsiu, e meriton një falënderim të tillë, se më të vërtetë është e angazhuar jashtëzakonisht shumë në punët e Kuvendit të Komunës. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës,

PREZANTOJ

Aktivitetin e Kuvendit të Komunës, të përmbledhur në materialin me tekstin: Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2024/Lënda: 01Nr. 104/02-1704/25.

6. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.104/02-31207/24 për miratimin e nismës për bashkëpunim ndër komunal me Komunën Iznik në Bursa të Turqisë;

Kryesuesi i Kuvendi: Nga MAPL është kërkuar riformulim i një fjale, ashtu që bashkëpunimin ndër komunal me bërë, bashkëpunim komunal ndërkombëtar. E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Ky a është rishqyrtim i vendimit, jo shfuqizim?

Kryesuesi i Kuvendi: Është rishqyrtim, ka me u ndryshuar vetëm një fjalë. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 24. Nuk ishte Betim Shala. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e nismës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar me Komunën Iznik në Bursa të Turqisë/ Lënda: 01Nr. 104/02-2159/25.

Me marrjen e këtij Vendimi, Vendimit 01Nr.104/02-31207/24 i datës 24.12.2024 për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën e Iznik të Turqisë, nuk ka fuqi ekzekutuese.

7. Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendi: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 24. Nuk ishte Betim Shala. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025/Lënda: 01Nr. 060/01-2303/25.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 11:56. Nga 25 anëtarë të KK sa ishin pjesëmarrës në këtë mbledhje, deri në fund të mbledhjes qëndruan 24 anëtarë, ndërkaq anëtari Betim Shala ka dal pak me herët nga mbledhja.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

**Nga Mbledhja e I (parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin
2025, mbajtur me 31.01.2025**

1. Kemal Murseli,
2. Brahim Imishti.....,
3. Hamide Luma,
4. Kadri Krivenjeva,
5. Lirije Dema.....,
6. Rrustem Zenuni.....,
7. Edon Baftiu,
8. Selajdin Troni,
9. Fatmir Bunjaku,
10. Bashkim Krasniqi,
11. Florina Lika-Vishi,
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....,
13. Agim Mani,
14. Kadrije Lika-Troni,
15. Burim Shehu,
16. Naim Beça,
17. Raif Kasa,
18. Ernesta Krasniqi.....,
19. Bashkim Luma,
20. Arta Avdiu,
21. Ardita Rrahmani,
22. Besnik Salihu,
23. Betim Shala,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Edona Luzha.....,
26. Ekrem Livoreka.....,
27. Agim Çaka......



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 26.02.2025

Për: Anëtarët e Kuvendit: **Burim Shehu,**
Kadrie Lika -Troni,
Bashkim Luma dhe
Selajdin Troni

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të japim sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, më datë, **31.01.2025**, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

Pyetjet dhe kërkesat

- **Burim Shehu:** Në lagjen "Besnik Begunca", nga sistemi i rrjetit të ujit që është prishur, janë shkaktuar 6 gropa, ndërkaq nuk janë sanuar ende. A ka mundësi me ditur, A do të sanohen ato gropa me asfalt? Këtë po e potencoj, sepse po kanë shumë probleme edhe fëmijët edhe veturat që kalojnë atypari.
- **Kadrije Lika-Troni:** Të ura e konakut, është vështirësuar kalimi i veturave për shkak të një grope të madhe. Sinqerisht nuk e di kah po kaloni ju që nuk po e vëreni. Kërkoj nga drejtoria përkatëse intervenim të menjëhershëm të asaj grope.
- **Bashkim Luma:** E kam një kërkesë për rrugën "Osman Luma" në f. Glloboçicë, e cila ka kalueshmëri shumë të lartë, sidomos nga nxënësit, aty ka probleme të ndryshme, si çështja e mbetjes së ujit në rrugë gjatë sezonit të dimrit dhe dëmtimi i rrugës në çdo 3-4 metra.
- **Selajdin Troni:** Kam një kërkesë për DSHPE, rruga: "Hamëz Jashari", është një kanal i madh i hapur. Kërkoj të shqyrtoni mundësitë për me rregullua ai kanal.

Përgjigje

Komuna e Kaçanikut ka të kontraktuar kompaninë për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale. Intervenimet në rrugët lokale kryhen bazuar në nevojat e paraqitura në teren në çdo periudhë kohore gjatë tërë vitit (sanimin e gropave me shtresë asfalti, kubëza betoni, kalldërm, etj.). Zakonisht sanimi i defekteve të paraqituara në rrjetin e ujës-jellësit duhen të kryhen nga KRU "Bifurkacioni" me urgjencë dhe bazuar në Rregulloren për Taksat komunale e kryejnë pagesën për sipërfaqen e asfaltit të dëmtuar duke e sjellë gjendjen e mëparshme deri nën asfalt e më pas komuna përmes kësaj kontrate aktive bënë mbulimin me shtresën përkatëse.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!
Me respekt,


Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-s